



Banka e Shqipërisë  
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian\*

# VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


3 SHKURT 2025

*\* Vrojtimet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e Komisionit Evropian për harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit.*

## VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) ra me 0.8 pikë në janar. Pavarësisht ngadalësimit, niveli i tij aktual qëndron rreth 6 pikë mbi mesataren afatgjatë (Grafik 1). Në rënien e TNE-së ndikoi dobësimi i besimit në të gjithë sektorët, me përjashtim të sektorit të shërbimeve. Ky i fundit dha një kontribut pozitiv në treguesin e agreguar të ekonomisë për muajin janar (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike, TNE (mesatarja afatgjatë=100)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

**Treguesi i besimit të industrisë (TBI)** vijoi prirjen ngadalësuese që nga tremujori i tretë i vitit të kaluar, duke shënuar rënie me 4.7 pikë përqindje në muajin janar. Pavarësisht këtij zhvillimi, niveli i tij vijon të qëndrojë 2 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafiku 2). Rënia e TBI-së në janar u përcaktua nga vlerësimet më pesimiste për kontratat porositëse të bizneseve, veçanërisht ato nga eksportet. Situata e prodhimit industrial aktual vlerësohet pothuaj e pandryshuar kundrejt një muaji më parë. Bizneset vlerësojnë në rënie të lehtë gjendjen e inventarëve, pasi kishin raportuar për rritje të tyre dy tremujorët e mëparshëm. Pritjet për çmimet në të ardhmen kanë shënuar rënie të lehtë krahasuar me muajin e kaluar (Tabelë 2, sektori i industrisë).

**Treguesi i besimit në ndërtim (TBN)** u ul me 4.1 pikë përqindje në janar. Megjithatë niveli i tij vijon të qëndrojë ndjeshëm mbi mesataren historike (Grafik 2). Rënia e TBN-së u përcaktua nga rishikimi për poshtë i vlerësimeve të bizneseve për aktivitetin aktual ndërtues. Nga ana tjetër, vlerësimet e bizneseve për kontratat porositëse shënuan rritje të lehtë këtë muaj. Pritjet për punësimin dhe për çmimet në të ardhmen u rritën (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve\*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


Shënim: \*Grafiku paraqet vlera të standardizuara për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

**Treguesi i besimit në shërbime (TBSH)** u rrit me 4.4 pikë përqindje në janar. Ky tregues qëndron 1.3 pikë përqindje mbi nivelin e mesatares historike (Grafik 2). Në rritjen e TBSH-së kontribuuan vlerësimet më pozitive të bizneseve për ecurinë aktuale të aktivitetit të tyre dhe për nivelin aktual të kërkesës. Po ashtu, pritjet për nivelin e punësimit në të ardhmen janë rritur (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

**Treguesi i besimit në tregti (TBT)** u ul me 2.9 pikë përqindje në muajin janar. Niveli i TBT-së është rreth 4.1 pikë mbi mesataren historike (Grafik 2). Në rënien e TBT-së ndikoi vlerësimi më pesimist për ecurinë aktuale të biznesit. Nga ana tjetër, pritjet për nivelin e punësimit në të ardhmen kanë vijuar të rriten edhe këtë muaj. Pritjet për çmimet në të ardhmen janë rishikuar me rritje (Tabelë 2, sektori i tregtisë).


**Treguesi i besimit konsumator (TBK)** ra me 3 pikë përqindje në muajin janar, duke e çuar nivelin e këtij treguesi nën mesataren historike, për herë të parë nga muaji qershor 2024 (Grafik 2). Rënia e TBK-së këtë muaj ka reflektuar zhvillime më të dobëta në të gjithë komponentët përbërës të tij. Kështu, pritjet për situatën e përgjithshme të ekonomisë, pritjet për gjendjen e tyre financiare në të ardhmen dhe për blerjet në shuma të mëdha janë rishikuar për poshtë. Pritjet e konsumatorëve për çmimet në të ardhmen janë rritur në janar (Tabelë 2, konsumatorët).

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit, gjatë muajve të ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet e konsumatorëve për papunësinë dhe çmimet, gjatë 12 muajve të ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shumë të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve \*

	Vlerat			2024				2025	Situata aktuale	
	min	mes	maks	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Koniunkturale **	Strukturore ***
Industri	-60.8	-8.7	5.7	3.7	0.8	-0.5	-1.8	-6.5	↓	+
Ndërtim	-58.4	-19.9	8.3	3.7	0.5	4.6	-1.1	-4.1	↓	++
Shërbime	-45.8	11.3	32.4	28.0	31.8	25.4	19.8	24.2	↑	+
Tregti	-33.3	1.1	17.2	10.2	10.2	11.8	8.1	5.2	↓	+
Konsumator	-40.8	-26.5	-16.3	-25.2	-24.8	-22.4	-24.6	-27.6	↓	-

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

\*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

\*\*) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

\*\*\*) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++) , kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (-), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

	2024								2025
	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar
<b>INDUSTRIA</b>									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	16.2	16.6	17.3	17.7	18.3	17.1	20.4	13.9	14.2
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-8.0	-8.8	-6.4	-1.6	-2.2	-6.3	-10.2	-9.0	-10.3
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-15.5	-15.3	-16.7	-11.6	-5.1	-8.5	-11.7	-10.3	-23.3
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	-0.1	3.0	5.6	0.9	0.3	-7.2	-3.1	-0.1	-2.1
Prodhimi pritje (pyetja 5)	28.3	28.5	31.1	30.3	29.1	23.7	34.7	32.1	31.6
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	6.3	8.7	10.1	14.4	16.9	13.1	12.3	12.2	11.8
Punësimi pritje (pyetja 7)	4.9	0.5	6.8	5.5	5.6	5.7	12.2	14.1	11.9
<b>NDËRTIMI</b>									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	18.4	18.4	21.9	28.1	29.9	23.7	30.6	24.5	16.8
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-20.6	-22.4	-20.1	-21.4	-22.5	-22.8	-21.5	-26.7	-25.0
Punësimi pritje (pyetja 4)	12.2	14.1	17.1	16.7	18.8	17.5	19.0	18.5	24.5
Çmimet pritje (pyetja 5)	15.7	10.5	15.5	14.1	10.2	8.5	4.8	16.9	17.4
<b>SHËRBIME</b>									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	33.7	25.6	28.4	25.7	27.4	31.8	27.4	20.7	26.0
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	31.1	30.7	30.1	23.5	28.5	31.7	23.4	18.9	22.4
Kërkesa pritje (pyetja 3)	36.0	25.6	33.0	31.1	30.6	28.8	34.1	34.3	33.0
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	9.9	12.7	14.9	8.0	17.9	13.4	12.1	9.3	8.4
Punësimi pritje (pyetja 5)	10.8	11.8	10.9	10.1	10.8	7.0	5.9	8.4	9.0
Çmimet pritje (pyetja 6)	6.7	9.3	4.3	10.5	9.6	9.0	8.6	12.7	10.2
<b>TREGTIA</b>									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	20.2	15.1	10.1	17.2	16.7	18.6	21.6	16.6	9.4
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	3.9	4.8	6.6	0.0	-0.9	-0.2	-2.7	1.0	0.1
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	29.4	23.8	23.0	21.9	26.0	22.4	22.9	16.1	22.1
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	33.4	23.5	18.8	27.1	34.4	28.5	27.2	21.4	28.7
Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së)	7.8	2.9	2.1	8.9	3.6	1.8	2.0	-0.5	1.0
Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6)	3.2	7.0	4.5	7.1	-0.7	3.5	-4.3	9.1	12.3
<b>KONSUMATORI</b>									
Situata financiare aktuale (pyetja 1)	-7.6	-8.8	-7.7	-6.8	-6.9	-6.0	-3.9	-5.5	-10.1
Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së)	4.2	2.8	2.4	3.0	2.8	2.4	4.1	4.0	0.5
Situata ekonomike aktuale (pyetja 3)	-12.3	-13.8	-13.9	-12.9	-14.3	-11.4	-9.4	-10.9	-13.1
Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së)	2.5	1.1	1.4	3.4	2.0	2.1	5.0	3.1	0.5
Çmimet aktuale (pyetja 5)	33.4	32.4	29.8	29.1	24.6	28.1	24.3	23.0	25.3
Çmimet pritje (pyetja 6)	-4.7	-2.2	-5.7	-5.6	-10.2	-9.9	-7.7	-9.6	-6.1
Papunësia pritje (pyetja 7)	-1.1	1.6	0.1	0.2	0.5	0.2	0.5	1.0	2.6
Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së)	-63.0	-63.6	-62.1	-60.6	-60.8	-60.7	-57.3	-61.7	-62.9
Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së)	-51.9	-49.2	-47.3	-46.5	-44.7	-43.2	-41.2	-43.8	-48.4
Kursimi aktual (pyetja 10)	-45.6	-45.8	-44.0	-43.9	-43.6	-41.6	-41.4	-41.3	-46.4
Kursimi pritje (pyetja 11)	-40.3	-38.4	-38.2	-36.4	-36.3	-39.4	-37.7	-35.0	-46.4
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12)	3.0	3.2	2.7	4.4	5.7	6.2	5.5	7.3	3.3

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

## ANEKS

### SHPJEGIME METODOLOGJIKE

**Balanca** është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vërtetimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

**Treguesi i Besimit (TB)** ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve, të cilat kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

**Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE)** ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.